



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr 16608 prot.

Lezhë, më: 24.08.2025

PROJEKT-V E N D I M

NR. _____, Datë 24.09, 2025

PËR

MIRATIMIN E HAPJES SË RRUGËS “BY-PASS-i I SHËNGJINIT”, NJËSIA
ADMINISTRATIVE SHËNGJIN, BASHKIA LEZHË, NË FONDIN
PYJOR BASHKIAK

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor kombëtar" pas shqyrtimit të dokumentacionit, Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON:

1. Miratimin e hapjes së rrugës "ByPass i Shëngjinit", Njësia Administrative Shëngjin, sipas projektit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Sipërfaqja që do të ndërtohet rruga detajohet si mëposhtë:
 - 0.57 km rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **33**, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit".
 - 0.87 km rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **34a**, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit".
 - 0.37 km rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **35c**, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit".
 - 0.30 km rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **36a**, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit".
 - 0.63 km rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **37a**, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit".

- **0.68 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **40**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
- **0.67 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **39a**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
- **0.19 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **43b**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
- **1.26 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **43**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
- **0.75 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **45a**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
- **0.22 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **46a**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
- **0.19 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **46b**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
- **0.21 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **47b**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
- **0.04 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **47c**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
- **0.31 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **52**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
- **0.32 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **51a**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
- **0.09 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **51b**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
- **0.06 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **60b**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
- **0.66 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **61a**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
- **0.12 km** rrugë me gjerësi 9m, në ngastrën pyjore **62a**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.

3. Për sipërfaqen që nevojitet për ndërtimin, të bëhet përditësimi kadastral duke pasqyruar vetëm zvogëlimin në volum dhe jo në sipërfaqe.
4. Të bëhet rehabilitimi i sipërfaqes pyjore në skarpatat e rrugës që do të ndërtohet.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr 16608/prot.

Lezhë, më: 24.09.2025

RELACION
PËR SHPJEGIMIN E PROCEDURËS PËR SIPËRFAQET QË DO TË PREKEN NGA
NDËRTIMI I RRUGËS AUTO "BY-PASS-i I SHËNGJINIT", NJËSIA
ADMINISTRATIVE SHËNGJIN, BASHKIA LEZHË

Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban në Bashki, ka paraqitur kërkesën me numër 15924 datë 11.09.2025 pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve për marrjen në përdorim të sipërfaqes pyjore për ndërtimin e rrugës auto By-Pass-i i Shëngjinit, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë.

Duke qenë se kemi të bëjmë me një vepër që ndërtohet për nevojat e komunitetit dhe financohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për llogari të Bashkisë Lezhë, sipërfaqja pyjore nuk jepet në përdorim, pasi prona është e vetë Bashkisë, por bëhet miratimi i hapjes së rrugës me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Bazuar në ligjin 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", si dhe në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", kërkesa i drejtohet Këshillit Bashkiak për miratimin e hapjes së rrugës auto By-Pass-i i Shëngjinit, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë me një gjatësi **8.49 km** që kalon në sipërfaqe pyjore në pronësi të Bashkisë Lezhë.

Në këto raste, sipas VKM-së së sipërcituar nuk bëhet heqje nga fondi pyjor, por për efekt kadastral bëhet vetëm pakësimi në volum i materialit drusor që pritet në trasenë e ndërtimit të rrugës auto. Për sipërfaqen prej **7.64 ha** pyll që dëmtohet si rezultat i ndërtimit të rrugës auto do të bëhet rehabilitimi mjedisor në raportin e barazimit apo tre fishit të sipërfaqes së përdorur, siç e përcakton VKM-ja numër 537 datë 22.09.2022 "Për përcaktimin e kostove të përlllogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor". Për këtë rast sipërfaqja që i nënshtrohet rehabilitimit mjedisor do të jetë **17.65 ha**.

Në këto kushte, bazuar në ligjin numër 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", ligjin numër 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM-në numër 888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", i propozojmë Këshillit Bashkiak të shprehë miratimin e hapjes së rrugës auto By-Pass-i i Shëngjinit, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë me gjatësi **8.49 km** që kalon në

parcelat pyjore 33, 34a, 35c, 36a, 37a, 40, 39a, 43b, 43, 45a, 46a, 46b, 47b, 47c, 52, 51a, 51b, 60b, 61a dhe 62a të ekonomisë pyjore "Mali i Rrencit".

Rruga auto me gjatësi 8.49 km do të ndërtohet në sipërfaqen pyjore prej 7.64 ha pyll në pronësi të Bashkisë, sipas raportit tekniko ekonomik bashkangjitur Projekt-Vendimit.

KRYETARI
Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 16608/2 Prot.

Lezhë më, 24/09/2025

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË

Pjerin NDRËU



RAPORT

**MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR SIPËRFAQET PYJORE QË DO
TË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS AUTO BY-PASSI SHËNGJIN NJËSIA,
ADMINISTRATIVE SHËNGJIN, BASHKIA LEZHË**

Bazuar në kërkesën me numër 15924 datë 11.09.2025 të paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, Bashkia Lezhë, “Kërkesë për marrje në përdorim të sipërfaqes pyjore”, për ndërtimin e rrugës auto By-Passi i Shëngjinit, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, grupi i punës i përbërë nga **Inxh. Ardit Molla, Inxh. Blerim Rrema dhe Inxh. Eralba Mirashaj**, hartoi raportin mbi vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqeve pyjore që preken nga zbatimi i këtij projekti.

Duke filluar nga data 15.09.2025 (datë e cila është protokolluar kërkesa pranë Drejtorisë së Bujqësisë Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve) deri në datën 17.09.2025, grupi i punës mori në shqyrtim kërkesën e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban dhe realizoi verifikimin në terren e në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore, objekt për ndërtimin e rrugës auto me gjerësi 9m, në sipërfaqen e kërkuar.

Duke qenë se kemi të bëjmë me një vepër që ndërtohet për nevojat e komunitetit dhe financohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për llogari të Bashkisë Lezhë, sipërfaqja pyjore nuk jepet në përdorim, pasi prona është e vetë Bashkisë, por bëhet miratimi i hapjes së rrugës me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor, rezulton se sipërfaqja pyjore e kërkuar për ndërtimin e rrugës është **7.64 ha** e cila shtrihet në pasuritë si mëposhtë:

	Ngastra	Ek Pyjore
1	33	Mali i Rrencit
2	34a	Mali i Rrencit
3	35c	Mali i Rrencit
4	36a	Mali i Rrencit
5	37a	Mali i Rrencit
6	40	Mali i Rrencit
7	39a	Mali i Rrencit
8	43b	Mali i Rrencit
9	43	Mali i Rrencit
10	45a	Mali i Rrencit
11	46a	Mali i Rrencit
12	46b	Mali i Rrencit
13	47b	Mali i Rrencit
14	47c	Mali i Rrencit
15	52	Mali i Rrencit
16	51a	Mali i Rrencit
17	51b	Mali i Rrencit
18	60b	Mali i Rrencit
19	61a	Mali i Rrencit
20	62a	Mali i Rrencit

Këto sipërfaqe pyjore janë në pronësi të Bashkisë Lezhë sipas VKM-së nr. 433 datë 08.06.2016 e ndryshuar me VKM-në nr 684 datë 02.09.2020 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave të Bashkive”.

Përshkrimi kadastral parcellar i sipërfaqeve në objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat që i bashkangjiten këtij raporti teknik.
Nga verifikimi në terren rezultojnë të dhënat e pasqyruara në tabelat bashkangjitur raportit teknik.

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, Bashkia Lezhë nuk e ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbujve në pasuritë pyjore si mëposhtë e cila është në pronësi të Bashkisë Lezhë.

Nr. Rendor	Nr. Ngastre	Ekonomia Pyjore	Forma e Qeverimit	Përbërja e grumbullit Pyjor
1	33	Mali i Rrencit	Shkurre	Te perziera
2	34a	Mali i Rrencit	Shkurre	Te perziera
3	35c	Mali i Rrencit	Trungishte	Pi
4	36a	Mali i Rrencit	Trungishte	Pi
5	37a	Mali i Rrencit	Shkurre	Frb
6	40	Mali i Rrencit	Shkurre	Te perziera
7	39a	Mali i Rrencit	Cungishte	Dushqe
8	43b	Mali i Rrencit	Kullotë	Kullote
9	43	Mali i Rrencit	Cungishte	Dushqe
10	45a	Mali i Rrencit	Cungishte	Dushqe
11	46a	Mali i Rrencit	Trungishte	Pi
12	46b	Mali i Rrencit	Trungishte	Pi
13	47b	Mali i Rrencit	Trungishte	Pi
14	47c	Mali i Rrencit	Trungishte	Pi
15	52	Mali i Rrencit	Cungishte	Dushqe
16	51a	Mali i Rrencit	Trungishte	Pi
17	51b	Mali i Rrencit	Trungishte	Pi
18	60b	Mali i Rrencit	Cungishte	Dushqe
19	61a	Mali i Rrencit	Cungishte	Dushqe
20	62a	Mali i Rrencit	Cungishte	Dushqe

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”.

Pika 15 e VKM-së së sipërcituar; Përfshihen nga procedura e ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore, projektet e ndërtimit të infrastrukturave lineare rrugore të cilat në përputhje me projektet e miratuara kërkojnë për çdo trase të pastruar nga vegjetacioni, me gjerësi më të vogël se 10m, për efekt kadastral, bëhet vetëm zvogëlim në volum, por jo në sipërfaqe, sipas legjislacionit në fuqi.

Për të llogaritur materialin drusor që do të pritët janë marrë të dhëna nga kadastra dhe janë nxjerrë volumet përkatëse për secilën ngastër.

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative, Bashkia kryen aktivitetin për sipërfaqen e kërkuar, vetëm pas miratimit të hapjes së rrugës me vendim të Këshillit Bashkiak.

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të

fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".

a. Vlerën e sipërfaqes së dhënë në përdorim lekë/ha/vit

b. Vlerën e përdorimit të rrugës lekë/km/vit

c. Vlera e lëndës drusore që do pritët është 128.438,5 (sipas tabelës 4)

1. Lëndë punimi 29.52m³ X 2500 lekë = 73800 lekë

2. Dru zjarri 36.01m³ X 250 lekë = 9002.5 lekë

3. Dru zjarri 76.06 m³ X 600 lekë = 45636 lekë

Totali (a+b+c) = 128.438,5 Lekë

Raporti teknik nuk prodhon efekte financiare për pagesën e lëndës drusore duke qenë se kemi të bëjmë me pyll në pronësi të Bashkisë.

Bashkia Lezhë do të planifikojë fondin për rehabilitimin mjedisor, sipas VKM-së nr 537 datë 22.09.2021 "Për përcaktimin e kostove të përlllogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor" të përcaktuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak.

Në këtë raport janë bërë vlerësimet e sipërfaqeve pyjore në të cilat do të ndërtohet rruga auto By-Passi i Shëngjinit, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë.

Bashkangjitur raportit, hartat, tabelat vlerësuese.

HARTUAN RAPORTIN

Inxh. Ardit Molla



Inxh. Blerim Rrema



Inxh. Eralba Mirashaj



KONTROLLUAN RAPORTIN

PËRGJEGJËSI

Inxh. Artan Palushi



DREJTORI

Paulin Gjergji



PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR (sipas verifikimit ne terren)
(Ndertim i rruges se varrezave ne fshatin Rras Njesia Administrative Ungrej Bashkia Lezhe.)

ID. Prones	Ekon.Pyjore	Pare	Perb. grumb	Funksioni	Forma Qeverisjes	Te dhena te grumbullit pyjor					Fuqia lendore		
						Mosha	K.D	D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Katet	per ha m3
LE2700033	Mali I Rrencit	33	Te perziera	Prodhues	shkurre							1	26.5
LE2700034a	Mali I Rrencit	34a	Te perziera	Prodhues	shkurre							3.63	123.75
LE2700035c	Mali I Rrencit	35c	Pi	Prodhues	trungishte							2.32	26
LE2700036a	Mali I Rrencit	36a	Pi	Prodhues	trungishte							3	58.5
LE2700037a	Mali I Rrencit	37a	Frb	Prodhues	shkurre							1.46	35.23
LE2700040	Mali I Rrencit	40	Te perziera	Prodhues	shkurre							9.6	57.6
LE2700039a	Mali I Rrencit	39a	Dushqe	Prodhues	Cungishte							12.54	412.94
LE2700043b	Mali I Rrencit	43b	Kullote	Kulloror	Kullote							0	0
LE2700043b	Mali I Rrencit	43	Dushqe	Prodhues	Cungishte							31.41	920.94
LE2700045a	Mali I Rrencit	45a	Dushqe	Prodhues	Cungishte							20.9	336.91
LE2700046a	Mali I Rrencit	46a	Pi	Prodhues	trungishte							19.6	88.4
LE2700046b	Mali I Rrencit	46b	Pi	Prodhues	trungishte							9.59	69.34
LE2700047b	Mali I Rrencit	47b	Pi	Prodhues	trungishte							3.64	37.42
LE2700047c	Mali I Rrencit	47c	Pi	Prodhues	trungishte							17	79.39
LE2700052	Mali I Rrencit	52	Dushqe	Prodhues	Cungishte							10.4	216.84
LE2700051a	Mali I Rrencit	51a	Pi	Prodhues	trungishte							94	2432.72
LE2700051b	Mali I Rrencit	51b	Pi	Prodhues	trungishte							3.2	2.88
LE2700060b	Mali I Rrencit	60b	Dushqe	Prodhues	Cungishte							10.5	289.59
LE2700061a	Mali I Rrencit	61a	Dushqe	Prodhues	Cungishte							7	255.92
LE2700062a	Mali I Rrencit	62a	Dushqe	Prodhues	Cungishte							11.67	530.99

PLOTËSOI:

Inxh. Ardit Molla

Inxh. Blerim Rrema

Inxh. Eralba Mirashaj

PËRGJEGJËSI

Inxh. Artan Palushi

Bashkia Lezhe

Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve

Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave

TABELË E PËRSHKRIMIT TË SIPËRFAQES KULLOSORE

Tabela 2

(Ndërtim i rrugës auto By-Passi i Shëngjinit, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë.)

ID Prone	Ekonomia Kullosore	Parcela	Bimesia ne %		Sip.sipas tipit te kullotes ne ha			Ngarkesa ne krere qe kulloshin			Vlera e kullotes 000/lek	
			Legum, Gram, te tjera	←	Dimerore	Verore	Total	Dhen	Dhi	Te trasha Total	Ha	Total
LE2700043b	Mali I Rrencit	43b										

PLOTËSOI:

Inxh. Ardit Molla

Inxh. Blerim Rrema

Inxh. Eralba Mirashaj

PËRGJEGJËSI

Inxh. Artan Paqushi

Bashkia Lezhe

**Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve
Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave**

INVESTIME TE KRYERA NE VITE

Tabela 3

(Ndërtim i rrugës auto By-Passi i Shëngjinit, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë.)

ID	Perdorimi	Ekon.pyj/ kullos	Parc	Sip total ha	Sip me punime	Viti I kryerjes punimeve	Punimi I kryerjes pyllezim	Punimi I kryer ne ha/m3 permires	sist.mal	Vlera investimit 000/leke
LE2700033	shkurre	Mali I Rrencit	33	26.5						
LE2700034a	shkurre	Mali I Rrencit	34a	34.09						
LE2700035c	trungishte	Mali I Rrencit	35c	11.2						
LE2700036a	trungishte	Mali I Rrencit	36a	19.5						
LE2700037a	shkurre	Mali I Rrencit	37a	24.13						
LE2700040	shkurre	Mali I Rrencit	40	6						
LE2700039a	Cungishte	Mali I Rrencit	39a	32.93						
LE2700043b	Kullote	Mali I Rrencit	43b	2.2						
LE2700043b	Cungishte	Mali I Rrencit	43	29.32						
LE2700045a	Cungishte	Mali I Rrencit	45a	16.12						
LE2700046a	trungishte	Mali I Rrencit	46a	4.51						
LE2700046b	trungishte	Mali I Rrencit	46b	7.23						
LE2700047b	trungishte	Mali I Rrencit	47b	10.28						
LE2700047c	trungishte	Mali I Rrencit	47c	4.67						
LE2700052	Cungishte	Mali I Rrencit	52	20.85						
LE2700051a	trungishte	Mali I Rrencit	51a	25.88						
LE2700051b	trungishte	Mali I Rrencit	51b	0.9						
LE2700060b	Cungishte	Mali I Rrencit	60b	27.58						
LE2700061a	Cungishte	Mali I Rrencit	61a	36.56						
LE2700062a	Cungishte	Mali I Rrencit	62a	45.5						

Kjo table plotesohet nese ka pasur investime te realizuar ne vite

PLOTËSOI:

Inxh. Ardit Molla

Inxh. Blerim Rrema

Inxh. Eralba Mirashaj

PËRQJEGJËSI

Inxh. Artan Palushi

Bashkia Lezhe

Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve
Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave

TABELA PERMBLEDHJESE E VLERESIMIT FINANCIAR

Tabela 4

(Ndërtim i rrugës auto By-Passi i Shëngjinit, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë.)

Perdorimi i territorit	Sip.Ha	Asortimenti	Volumi m3	Vlera		Sipërfaqja ne ha	Vlera e sipërfaqes ne perdorim		Gjatesia e perdorimit km rrugë	Tarifa dhenie ne perdorim lek/km/vit		TOTALI
				lek/m3	Shuma I		lek/ha per 2 vjet	Shuma II		per 2 vjet	Shuma III	
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	I+II+III
Trungishte pi	0	dru zjarri	36.01	250	9002.5	0	0	0	0	0	0	9002.5
Trungishte Pi	0	lpm+t	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Cungishte	0	dru zjarri	66.04	600	39624	0	0	0	0	0	0	39624
Cungishte	0	lpm+t	29.52	2500	73800	0	0	0	0	0	0	73800
Shkurre	0	dru zjarri	10.02	600	6012	0	0	0	0	0	0	6012
Kullote	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
B.pyjore+Djerr	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Inproduktive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Bime mjek/med	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjuetia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Invest realizuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithesejt	0.0	0	141.6		128438.5	0	0	0	0	0	0	128438.5

PLOTËSOI:

Inxh. Ardit Molla

Inxh. Blerim Rrema

Inxh. Eralba Mirashaj

PËRGJEGJËSI

Inxh. Artan Palushi

Bashkia Lezhe

Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve

Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave

TABELA PERMBLEDHESHE E VLERESIMIT FINANCIAR

Tabela 4

(Nderitim i rruges auto By-Passi i Shengjinit, Njesia Administrative Shengjin, Bashkia Lezhë.)

Perdorimi i territorit	Sip.Ha qe hiqet	Asortimenti	Volumi m3	Vlera		Siperfaqja ne perdorim ne ha	Vlera e siperfaqes ne perdorim			Gjatesia e perdorimit km rruge	Tarifa dhenie ne perdorim lek/km/vit		TOTALI
				lek/m3	Shuma I		lek/ha per 2 vjet	Shuma II	per 2 vjet		Shuma III		
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	13	I+II+III
Trungishte pi	0	dru zjarri	36.01	250	9002.5	0	0	0	0	0	0	9002.5	0
Trungishte Pi	0	lpm+t	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Cungishte	0	dru zjarri	66.04	600	39624	0	0	0	0	0	0	39624	0
Cungishte	0	lpm+t	29.52	2500	73800	0	0	0	0	0	0	73800	0
Shkurre	0	dru zjarri	10.02	600	6012	0	0	0	0	0	0	6012	0
Kullote	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
B.pyjore+Djerr	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Inproduktive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Bime mjek/med	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjuetia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Invest realizuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithesejt	0.0	0	141.6		128438.5	0	0	0	0	0	0	128438.5	0

PLOTËSOI:

Inxh. Ardit Molla

Inxh. Blerim Rrema

Inxh. Eralba Mirashaj

PËRGJEGJËSI

Inxh. Artan Palushi

Bashkia Lezhe

Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve
Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave

LISTA E PRONAVE TË FONDIT PYJOR BASHKIAK QE PREK NGA OBJEKTET

Tabela 5

(Ndërtim i rrugës auto By-Passi i Shëngjinit, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë.)

Nr. ID pones	Ekonomia pyjore/Kullosore	Ng/n/ngast.	Siperfaqja qe hiqet nga fondi pyjor/kullosor ha	Siperfaqja qe preket ne fondin pyjor/kullosor ha	Gjatesia ne km		Tubacion/ kanal
					Rruge	Linje	
1	2	3	4	5	6	7	8
1 LE2700033	Mali I Rrencit	33	0	0	0.51	0.57	0
2 LE2700034a	Mali I Rrencit	34a	0	0	0.78	0.87	0
3 LE2700035c	Mali I Rrencit	35c	0	0	0.33	0.37	0
4 LE2700036a	Mali I Rrencit	36a	0	0	0.27	0.30	0
5 LE2700037a	Mali I Rrencit	37a	0	0	0.56	0.63	0
6 LE2700040	Mali I Rrencit	40	0	0	0.61	0.68	0
7 LE2700039a	Mali I Rrencit	39a	0	0	0.6	0.67	0
8 LE2700043b	Mali I Rrencit	43b	0	0	0.17	0.19	0
9 LE2700043b	Mali I Rrencit	43	0	0	1.13	1.26	0
10 LE2700045a	Mali I Rrencit	45a	0	0	0.68	0.75	0
11 LE2700046a	Mali I Rrencit	46a	0	0	0.2	0.22	0
12 LE2700046b	Mali I Rrencit	46b	0	0	0.17	0.19	0
13 LE2700047b	Mali I Rrencit	47b	0	0	0.19	0.21	0
14 LE2700047c	Mali I Rrencit	47c	0	0	0.03	0.04	0
15 LE2700052	Mali I Rrencit	52	0	0	0.28	0.31	0
16 LE2700051a	Mali I Rrencit	51a	0	0	0.29	0.32	0
17 LE2700051b	Mali I Rrencit	51b	0	0	0.08	0.09	0
18 LE2700060b	Mali I Rrencit	60b	0	0	0.05	0.06	0
19 LE2700061a	Mali I Rrencit	61a	0	0	0.6	0.66	0
20 LE2700062a	Mali I Rrencit	62a	0	0	0.1	0.12	0
					7.64	8.49	0

PLOTËSOI:

Inxh. Ardit Molla

Inxh. Blerim Rrema

Inxh. Eralba Mirashaj

PËRGJEGJËSI

Inxh. Artan Palushi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT DHE ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 15824 Prot.

Lezhë, më 11. 09 2025

Lënda : Kërkesë për marrje në përdorim të sipërfaqes pyjore

Drejtuar : Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve

KËTU

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" dhe të Ligjit nr.57 /2020 "Për pyjet" kërkohet miratimi i marrjes në përdorim të sipërfaqes pyjore për rrugën ByPass i Shwngjinit

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projektin teknik.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTORI

FLAMUR KUÇI



PLANVENDOSJA E BY PASS-IT TË SHËNGJINËT MBI HARTEN PYJORE

